

VENDIM
Nr. 133, datë 7.3.2018

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE PËR SISTEMIN E WEBGIS
PËR MENAXHIMIN E VEPRIMTARISË ARKEOLOGJIKE NË TERREN TË
AGJENCISË SË SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik (në vijim, ASHA).
 2. Baza e të dhënave të ASHA-s quhet “Databaza Gjeografike për Regjistrimin e Aktivitetit në Terren të ASHA-s” (në vijim, DGJRAT).
 3. Sistemi WebGIS për menaxhimin e veprimtarisë arkeologjike në terren (në vijim, SWMVAT) të ASHA-s përmban të dhëna për:
 - a) vëzhgimet arkeologjike të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - b) sondazhet arkeologjike të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - c) gërmimet arkeologjike të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - ç) zonifikimet arkeologjike të miratuara sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave;
 - d) proceset arkeologjike në kuadër të projekteve kërkimore-shkencore.
 4. Institucioni administrues i sistemit WebGIS të ASHA-s është Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
 5. Të dhënat parësore të DGJRAT-së janë si më poshtë vijon:
 - a) Shtresë poligon për vëzhgimet e projekteve të zhvillimit;
 - b) Shtresë pikë për sondazhet arkeologjike;
 - c) Shtresë poligon për gjetjet arkeologjike/ projektet shkencore;
 - ç) Shtresë pikë për gjetjet arkeologjike/projektet shkencore;
 - d) Shtresë poligon për zonifikimin arkeologjik;
 - dh) Të dhëna për projekte (emri i projektit, përshkrimi i gjetjes, të dhëna lidhur me gjetjet, statusi i ndjekjes nga ASHA, të dhëna për subjektin zbatues, të dhëna për aplikantin e ASHA-s).
 - e) Materiale digjitale (planvendosja e projektit e gjeoreferencuar, koordinata të gjetjes, shtresë GIS me zonat e vëzhgimit, raport arkeologjik).
 6. Dhënës i informacionit, sa i përket SWMVAT-së, është Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
 7. DGJRAT-ja komunikon me Gjeoportalin Kombëtar, i cili administrohet nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.
 8. Informacioni i shtresave gjeografike të databazës shërbehet me anë të WMS-së publike, duke e bërë këtë informacion të konsultueshëm nga sisteme të ngjashme të tjera dhe/ose në programe GIS Desktop.
 9. Subjektet e interesuara kanë nivel aksesit si lexues e konsultues, lidhur me informacionin e vënë në dispozicion, nëpërmjet aplikimit WebGIS në faqen e internetit të ASHA-s.
 10. Për punonjësit e ASHA-s, niveli i aksesimit përcaktohet në rregulloren e brendshme të organizimit dhe të funksionimit të SWMVAT-së.
 11. Baza e të dhënave të DGJRAT-së ka 3 nivele përdoruesish (*users, levels*):
 - a) Administratori;
 - b) Specialisti GIS i ASHA-s;
 - c) Punonjësi i thjeshtë i ASHA-s.
- Funksionet dhe të drejtat e secilit përdorues janë në përputhje me pozicionin e punës, të përcaktuara në procedurat e punës, si dhe të miratuara nga drejtori i ASHA-s, për secilin nga punonjësit e saj.
12. Subjektet e interesuara për SWMVAT-në janë si më poshtë vijon:

- a) Institucionet shtetërore të specializuara;
- b) Institucionet publike e private (persona juridikë që kanë interes për qëllime informimi);
- c) Grupet e interesit (subjekte private të licencuara në fushën e arkeologjisë);
- ç) Trupat akademikë (Instituti i Arkeologjisë, universitetet, studentët).

13. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të SWMVAT-së të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe të praktikave evropiane e ndërkombëtare në fushën e arkeologjisë, të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

14. Ngarkohet Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama